



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1018/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit DoniFERT shpk me seli në Glllogoc (Drenasi III) me numër identifikues 810247488, e përfaqësuar nga pronari A.E., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit I.D. avokat në Glllogoc, ndaj debitorit Jaha Company shpk me seli në Prishtinë, numër unik identifikues 810435801 përfaqësuar nga pronari J.H., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson SHA SCLR Partners në Prishtinë, me avokat B.P., me bazë juridike, përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës–Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP nr.179/22 i datës 20.04.2023, jashtë seancës me datën 21.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit DoniFERT shpk me seli në Glllogoc (Drenasi III) me numër identifikues 810247488, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhoma e shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP nr.179/22 i datës 20.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës –Dhoma e shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP nr.179/22 dt.20.04.2023, e ka Aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Jaha Company shpk me seli në Prishtinë, i datës 09.12.2016 i paraqitur kundër urdhrin përmbarimor P.nr.564/2016 i datës 02.12.2016 të lejuar nga përmbaruesi privat Fadil Hoxha në Prishtinë, dhe ka Shfuqizuar Urdhrin përmbarimor P.nr.564/2016 datës 02.12.2016 i nxjerr nga përmbaruesi privat Fadil Hoxha në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale kontestimore dhe përmbarimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori DoniFERT shpk me seli në Glllogoc (Drenasi III), me datën 02.12.2016 ka paraqitur propozim për përmbareim ndaj debitorit Jaha Company shpk me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Fatures nr.016DF/022 dt.03.10.2016. Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrin përmbareimor P.nr.564/2016 dt.02.12.2016, ka lejuar përmbareimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga fatura t,ia paguaj shumën prej 77,428.25€.

Kundër vendimit për lejimin e përmbareimit, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin ka kundërshtuar urdhrin përmbareimor në tersi si të pabazuar, për arsye se dokumenti i besueshëm nuk është i përshtatshëm për përmbareim dhe ka kundërshtuar borxhin e kërkuar nga kreditori so jo të vërtetë, në faturë nuk është përcaktuar kërkueshmëria e borxhit sepse fatura nuk ka afat të pagesës së detyrimit, nga kartela e brendshme financiare e debi kredive mes palëve ndërgjyqëse në kohën e parashtrimit të prapësimit ka qenë 13,135.50€ dhe jo aq sa ka kërkuar me përmbareim kreditori.

Kreditori në përgjigje në prapësimin e debitorit ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, se edhe pas tentimeve me ftese për pagesë të detyrimit, një pjesë me para të gatshme dhe një pjesë me pranim të shërbimeve të specializuara të shpimit dhe minimin nga debitori, ky i fundit nuk ka pranuar dhe nuk ka reaguar në ndonjë formë të përmbushjes së detyrimit, i propozojmë gjykatës që të refuzoj në tersi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin përmbareimor P.nr.564/2016 dt.02.12.2016 i nxjerr nga përmbareuesi privat.

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkalles së Parë, në rivendosje, duke vepruar sipas aktvendimeve të Gjykatës së Apelit PPP.179/17 dt.14.09.2018 dhe Ac.nr.1833/2020 dt. 11.08.2020, pas vlerësimit të prapësimit, shkresave tjera në lëndë, deklaratimet e palëve ndërgjyqëse të dhëna në seancat dëgjimore, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.179/22 datës 20.04.2023, me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Jaha Company shpk me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër kundër urdhrin përmbareimor P.nr.564/2016 i datës 02.12.2016 të lejuar nga përmbareuesi privat Fadil Hoxha në Prishtinë, dhe ka Shfuqizuar Urdhrin përmbareimor P.nr.564/2016 datës 02.12.2016 i nxjerr nga përmbareuesi privat Fadil Hoxha në Prishtinë.

Në arsyetim të aktvendimit, Dhoma e shkallës së parë, thekson se fatura 01DF/022 datës 03.10.2016 nuk përmban fare afat të pagesës, që përcaktohet me nenin 30 të LPP-së. Ndonëse fatura e përmbareimit nuk ka afat për kërkueshmëri të kredisë, kreditori i çështjes nuk ka dhënë deklaratë me shkrim me anë të së cilës do të tregonte nëse kredia e tij është bërë e kërkueshme apo jo. Gjykata konsideron se organi përmbareues nuk ka vepruar konform dispozitave nenit 38 par.1

dhe 2 të LPP\_së sepse nuk i ka kërkuar kreditorit plotësimet e nevojshme të cilat i udhëzon dhe i përcakton ligji i zbatuar, andaj fatura në qenësinë e saj nuk i përmbush të gjitha elementet e domosdoshme për të qenë e përshtatshme për përmbarrim. Gjykata nuk mundi ta marr parasysht ekspertizën financiare datës 11.04.2022, pasi që në konstatimin e dhënë theksohet se nuk mund të konstatohet borxhi me saktësi, nevojitet kryerja e një analize të përgjithshme e transaksioneve të kryera midis palëve ndërgjyqëse që nga fillimi i bashkëpunimit të tyre deri në momentin e paraqitjes së propozimit për përmbarrim

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se Dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka aprovuar propësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila fatura nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 të LPP-së.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se Dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve, rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga dhoma e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Dhomat e shkallës së dytë, gjithashtu vlerëson se në këtë rast janë zbatuar drejt vërejtjet e dhëna nga Gjykata e Apelit, se fatura përmbarrimore e bashkangjitur propozimit për përmbarrim nga ana e kreditorit, në origjinal, nuk përmban të dhënat e përcaktimit të afatit kohor për përmbushjen vullnetare të detyrimit nga ana e debitorit, ashtu që të mund organi përmbarrues para se të caktonte urdhrin përmbarrimor, të kërkonte nga kreditori nëse kredia e tij është bërë e kërkueshme, veprim i cili do të gjente mbështetje ligjore nga neni 30 i LPP-së, që parasheh:

*Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbarrimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë.* pastaj e njëjta faturë 01DF/022 datës 03.10.2016 në origjinal, e bashkangjitur propozimit për përmbarrim nga kreditori, nuk është e pranuar apo vulosur nga ana e debitorit, e cila provë do të dëshmonte se debitori ka pranuar borxhin e kërkuar nga kreditori, prandaj si e tillë kjo faturë përmbarrimore nuk i përmban të gjitha elementet që fatura të konsiderohet dokument i besueshëm dhe që do të gjente mbështetje në dispozitat ligjore nga neni 29 i LPP-së, i cili nen par.3 përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Po ashtu Dhoma e shkallës së dytë vlerëson edhe Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, neni 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe: “*Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore*”.

Si provë tjetër vendimtare, në këtë procedurë përmbarimore, Dhomat e shkallës së dytë vlerësoi edhe ekspertizën financiare datës 11.04.2022 e nxjerr sipas rekomandimeve të aktvendimit PPP.179/17 dt.14.09.2018 të Gjykatës së Apelit, ku edhe kjo gjykatë tani pranon konstatimet në arsyetimin e aktvendimit kontestues, se nuk ka qenë e mundur të vërtetohet me saktësi borxhi i arritur i debitorit ndaj kreditorit sipas faturës përmbarimore 01DF/022 datës 03.10.2016, sepse në mendimin profesional të ekspertit financiar është dhënë vlerësimi se për të përcaktuar saktë shumën e borxhit duhet një analizë e përgjithshme e të gjitha transaksioneve të kryera mes palëve ndërgjyqëse që nga fillimi i bashkëpunimit të tyre e deri në momentin e paraqitjes së propozimit për përmbarim.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, vlerëson se janë tërësisht të paqëndrueshme pretendimet lidhur me rregullsinë e faturës lëndore, për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me një faturë të lëshuar nga kreditori, e cila nuk dëshmon se është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori, pasi që e njëjta nuk është e protokoluuar dhe vulosur nga debitori, dhe si e tillë nuk është dokument i përshtatshëm për përmbarim.

Kjo gjykatë nuk mund ti pranoj pretendimet ankimore se fatura e lëshuar nga kreditori i plotëson kushtet ligjore nga neni 124 dhe 27 të LPP-së, për të qenë i përmbarueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me një faturë të lëshuar nga kreditori, e cila nuk dëshmon se është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori, nuk është e protokoluuar dhe vulosur nga debitori, gjatë procedurës përmbarimore, nuk është provuar me ekspertizën financiare datës 11.01.2022, se borxhi i kërkuar në faturën përmbarimore nga kreditori, është i saktë. Kjo gjykatë i analizoi edhe pretendimet tjera të kreditorit dhe rezultojë se të njëjtat janë të pathemelta, të paargumentuara dhe jo relevante për një vendosje ndryshe, prandaj edhe Dhomat e shkallës së dytë këto pretendime i refuzoj si të pabazuara dhe aktvendimin e shkallës së parë e vërtetoj.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Andaj, marrë për bazë faktin se procedura përmbarimore është rigoroze formale, në këtë procedurë bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin, kjo gjykatë udhëzon kreditorin që për realizimin e këtyre pretendimeve të drejtohet në procedura tjera siç është ajo kontestimore.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.1018/23 me datë 21.02.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha